



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË
VENDIM

Nr JO datë JO/05/2016

Per miratimin e projektit : “Menaxhimi i integruar i mbetjeve përmes riciklimit dhe kompostimit në 7 rajonet ndërkufitare”

Këshilli Qarkut Vlorë, i mbledhur sot më dt JO/05/2016 në zbatim të nenit 34 dhe nenit 77, të ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe udhëzimit Nr .8 pika 3 të Ministrisë së Financave datë 17.02.2003 “ Per Evidentimin, regjistrimin, perdorimin dhe raportimin e financave te huaja” Ligji Nr. 9840, datë 10.12.2007 për Ratifikimin e “Marrëveshjes Kuadër Ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane për Rregullat e Bashkëpunimit për Asistencën për Shqipërinë, në Kuadër të Zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA)”. Ligji nr.10332, datë 14.10.2010, për Ratifikimin e “Marrëveshjes Financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane “Për programin ndërkufitar ndërmjet Shqipërisë dhe Greqise, për vitin 2009”, të Komponentit të dytë të Instrumentit të Ndihmës së Paraaderimit (IPA) – Bashkëpunimi ndërkufitar për Shqipërinë , Fletore Zyrtare nr. 149, datë 08.11.2010, hyrja në fuqi: 23.11.2010, pasi mori në shqyrtim projektin e paraqitur nga Zedhenesja e Kryetarit dhe Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve.

Vendosi:

1. Të miratojë projektin “**Menaxhimi i integruar i mbetjeve përmes riciklimit dhe kompostimit në 7 rajonet ndërkufitare**” (Rajoni i Epirit, Rajoni i Ishujve Joniane, DIADYMA, EKETA per palën greke dhe Qarku i Vlorës, i Beratit, i Gjirokastrës dhe i Korcës për palën shqiptare) në kuadër të Programit Ndërkufitar IPA Greqi-Shqiperi 2014-2020 projekt Strategjik në partneritet të plotë me partnerët lokalë.
2. Vlera totale e projektit “**Menaxhimi i integruar i mbetjeve përmes riciklimit dhe kompostimit në 7 rajonet ndërkufitare**” bashke me vlerat e bashkëfinancimit është **400.000 Euro** nga ku vlera e bashkëfinancimit si kontribut i Këshillit të Qarkut është parashikuar në masën 15%.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut, Kabineti dhe Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 78 pika 3 të ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.


SADRIT DANAJ
KRYETARI



Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr: _____ prot. dt. ____/____/2016